



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
TIRANA PARKING
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Tiranë , më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[Data]: 26/09/2024

Drejtuar: **CLASS ASHENSOR Shpk** me adresë: Tiranë Njesia Administrative Nr.5, Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selite.

Procedura e prokurimit: “E Hapur”

Numri i referencës së procedurës: **REF-16217-08-14-2024**

Loti 1: REF-16222-08-14-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Shpenzime mirëmbajtje rrugë, vepra ujore, rrjet hidraulik, elektrik, telefonik, ngrohje etj (e ndare me lote)”

Loti 1 “Mirembajtje e ashensoreve”

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.51 datë 19 Gusht 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **“CLASS ASHENSOR” Shpk**

Emri i plotë i shoqërisë

L01325010Q

Numri i NIPT-t

Vlera: **1 756 500** (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) **lekë pa Tvsh.**

2. **“HASIMAJ ELEVATOR CO” Shpk**

Emri i plotë i shoqërisë

L11511001A

Numri i NIPT-t

Vlera: **1 960 000** (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) **lekë pa Tvsh.**

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “HASIMAJ ELEVATOR CO” Shpk

L11511001A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

arsyet e mëposhtme;

Operatori ekonomik “Hasimaj Elevator Co” ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertës në formën e policës së sigurimit me nr. serie 14542, e lëshuar nga shoqëria siguroese ANSIG. Referuar përmbajtjes së policës së sigurimit rezulton se operatori ofertues ka depozituar pranë shoqërisë siguroese, shumën prej **39,200** (tridhjetë e nëntë mijë e dyqind) lek, si kusht për sigurimin e ofertës dorëzuar nga operatori ekonomik.

Në pikën 3.1 të “Njoftimit të kontratës”, pjesë e dokumentave standarte të tenderit të publikuar në SPE është përcaktuar se për Lotin 1, me objekt “Mirëmbajtje ashensorësh”, vlera e sigurimit të ofertës e cila duhet të paraqitet nga ana e operatorëve ekonomik ofertues do të jetë **41,612.86** (*dyzet e një mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë pike tetëdhjetë e gjashtë*) lekë e cila përbën vlerën prej 2 % të fondit limit.

Nga krahasimi i vlerës së sigurimit të ofertës së paraqitur nga operatori “Hasimaj Elevator Co” në raport me vlerën e përcaktuar në “Njoftimin e kontratës”, rezulton vlera e siguruar nga operatori ofertues, e cila do të shërbej si garanci për përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga ky operator gjatë kësaj faze, është me e vogël se vlera e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik “Hasimaj Elevator Co” ne përmbushje të pikës 2.2.2 të kapacitetit financiar ka paraqitur pasqyrat financiare për vitet 2021,2022,2023. Nga shyrtimi përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi, përkatësisht të pasqyrave financiare të viteve 2021,2022 dhe 2023, rezulton se keto pasqyra nuk janë të konfirmuara nga organet tatimore, pasi nuk janë të shoqëruar me shkresën përcjellëse të Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe nuk përmbajnë vulën zyrtare të kësaj drejtorie, por janë paraqitur vetëm me firmën e administratorit të shoqërisë dhe vulën e kësaj të fundit.

Si rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesi “Hasimaj Elevator Co” në përmbushje të pikës 2.2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, nuk është në përputhje me përcaktimet e kësaj pike, për shkak se pasqyrat financiare të ngarkuara në SPE nuk janë të konfirmuara nga organet tatimore.

Lidhur sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofretave, vlerëson se ofertuesi “Hasimaj Elevator Co” nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar nuk përmbush kriteret kualifikuase të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit, përkatësisht vlerën e sigurimit të ofertës e cila është me e vogël se vlera prej 2% e fondit limit dhe pikën 2.2.2 të “kapacitetit ekonomik dhe financiar” për shkak se pasqyrat financiare të viteve 2021,2022 dhe 2023 të paraqitur nga ky operator nuk janë të konfirmuara nga organet tatimore.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **CLASS ASHENSOR Shpk**, me adresë: Tiranë Njesia Administrative Nr.5, Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selite, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1 756 500** (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) **lekë pa Tvsh**, totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Tirana Parking, Adresa: Rruga Ali Begeja, Ndërtesa 16, Kodi Postar 1017 Tiranë, Shqipëri, Tel/Fax +355 4 221111 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erinda Fino